



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera – Ministry of
Finance, Labour and Transfers*

**PROGRAMI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE TË
CENUESHËM TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË**

PËRMBAJTJE

LISTA E SHKURTESAVE	3
OBJEKTIVAT DHE SYNIMET KOHORE TË PROGRAMIT	4
BAZA LIGJORE DHE DEFINIMI I KONSUMATORËVE NË NEVOJË APO TË CËNUESHËM TË ENERGJISË ELEKTRIKE.....	4
TERMET E PËRDORURA NË KËTË PROGRAM.....	5
GRUPET E TARGETUARA.....	6
KRITERET E PËRFITIMIT DHE LLOGARITJA E SUBVENCIONIT	6
Mënyra e aplikimit	7
Kriteret e përgjithshme	7
Niveli maksimal i subvencionit	8
ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE TE INTERESIT	8

LISTA E SHKURTESAVE

ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DTP	Departamenti i Tatimit në Pronë
EF	Ekonomi Familjare
FShU	Furnizuesi i Shërbimit Univerzal
KZ	Komisioni Zbatues
KA	Komisioni i Ankesave
MFLT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MT	Testi i Mjeteve
QPS	Qendra për Punë Sociale

OBJEKTIVAT DHE SYNIMET KOHORE TË PROGRAMIT

Qëllimi kryesor i këtij Programi është të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë për konsumatorët e cenueshëm në sektorin e energjisë elektrike. Duke synuar zbatimin e politikave me objektiva specifike, programi siguron që konsumatorët e cenueshëm të kenë qasje të barabartë dhe të përballueshme në konsumin e energjisë elektrike, duke mbështetur financiarisht pagesën e faturës së energjisë elektrike për të përmirësuar mirëqenien e tyre të përgjithshme.

Ky Program është shumëvjeçar dhe zhvillohet si pjesë e tranzicionit energjetik të Republikës së Kosovës dhe gjithashtu si përgjigje ndaj rritjes së kostos së energjisë elektrike të shkaktuar nga kriza e fundit e energjisë në rajon dhe më gjerë. Programi fokusohet ekskluzivisht në mbështetjen financiare direkte, përmes subvencionimit të faturave të energjisë elektrike, pasi vlerësohet se ndihma financiare direkte në fatura të energjisë elektrike është një nga mënyrat më të mira për të mbështetur konsumatorët e cenueshëm.

Objektivat e përgjithshme:

- 1. Identifikimi i konsumatorëve të cenueshëm:** Programi synon të identifikojë konsumatorët e cenueshëm që kualifikohen për subvencionim të energjisë elektrike bazuar në kriteret objektive. Grupi Punues ka vendosur të përdorë testin e të ardhurave dhe testin e patundshmërisë si një qasje për të identifikuar konsumatorët e cenueshëm, pasi kjo qasje na lejon t'i drejtojmë mjetet financiare tek ata që kanë më shumë nevojë. Me këtë thjeshtohet procesi i identifikimit, promovohet shpërndarja efiçase e burimeve dhe nxitet barazia dhe konsistenca në identifikimin e konsumatorëve të cenueshëm.
- 2. Sigurimi i shpërndarjes së barabartë të subvencioneve:** Sigurimi që subvencionet e energjisë elektrike të shpërndahen në mënyrë të drejtë, është një prej synimeve kryesore të programit. Formula për kalkulimin e subvencioneve si dhe zbatimi i mekanizmit verifikues, sikurse konfirmimi i të ardhurave dhe vlerës së patundshmërive të ekonomive familjare nga Komisioni Zbatues në bashkëpunim me institucionet përkatëse, mundësojnë shpërndarjen e barabartë të subvencioneve.
- 3. Sigurimi i mbështetjes financiare për mbulimin e kostos së energjisë elektrike:** Objektiv tjetër i programit është të sigurojë që konsumatorët e cenueshëm të kenë fuqi financiare për të mbuluar koston e energjisë elektrike. Programi synon të lehtësojë barrën financiare përmes subvencionimit të faturave të energjisë elektrike.

BAZA LIGJORE DHE DEFINIMI I KONSUMATORËVE NË NEVOJË APO TË CËNUESHËM TË ENERGISË ELEKTRIKE

Njohja dhe garantimi i të drejtave të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike për konsumatorët e cenueshëm në Republikën e Kosovës bëhet përmes tre ligjeve, përkatësisht: Ligjit

Nr. 05/L-081 për Energjinë (më tutje: Ligji për Energjinë), Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike (më tutje: Ligji për Energjinë Elektrike), dhe Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë (më tutje Ligji për Rregullatorin e Energjisë).

Të tre ligjet, Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë, e definojnë konsumatorin në nevojë si konsumator familjar i cili për shkak të gjendjes sociale gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike. Ligji për Energjinë dhe Ligji për Energjinë Elektrike ngarkojnë Ministrinë për Ekonomi dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve që në konsultim me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe akterë të tjerë të zhvillojnë programe për përcaktimin e konsumatorëve në nevojë dhe një plan social të veprimit për Energji.

Legjislacioni që përcakton rregullat dhe masat për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike, specifikisht Ligji për Energjinë Elektrike, njeh dhe garanton të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike për konsumatorët në nevojë. Ligji për Energjinë Elektrike, përmes nenit 49 i cili ka të bëjë me mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, obligon Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (si Ministri përgjegjëse për financa dhe mirëqenie sociale) që në konsultim me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) dhe hisedarë të tjerë në sektorin e energjisë elektrike të zhvillojnë një program të detajuar për përcaktimin e statusit të konsumatorëve në nevojë, fushëveprimit të të drejtave të tyre, si dhe masave që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë në mbulimin e kërkesës së tyre për energji elektrike, i cili pastaj votohet nga Qeveria.

Neni 49, paragrafi 2, përcakton se programi duhet të përmbajë një nga elementet në vijim:

“2. Programi i trajtimit të konsumatorëve në nevojë i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të aprovohet nga Qeveria dhe do të përfshijë së paku një nga elementet në vijim:

2.1. caktimin e konsumatorëve në nevojë që përfitojnë nga programi i përcaktuar sipas këtij neni, si:

2.1.1. nuk do të përfshijë më shumë se një pakicë të konsumatorëve të energjisë elektrike në Kosovë;

2.1.2. do të jetë i kufizuar në konsumatorët e energjisë elektrike me të ardhurat më të ulëta që përdorin energji elektrike për furnizim për banimin e përhershëm, ku për përcaktimin e të ardhurave të ulëta, përveç të ardhurave, do të merren parasysh të gjitha asetet në dispozicion.”

TERMET E PËRDORURA NË KËTË PROGRAM

Ekonomi Familjare (EF)- është njësi familjare që përbëhet nga një ose më shumë persona që jetojnë së bashku dhe ndajnë të njëjtën banesë, të njëjtin njejsor elektrik dhe koston e energjisë elektrike.

Të hyrat mujore familjare- sipas këtij Programi, të hyra konsiderohen të gjitha të ardhurat mujore të ekonomisë familjare me përjashtim të kategorive: pensionet për personat me aftësi të kufizuara, kompensimet për personat e verbër, pensionet për invaliditet në punë, kompensimet për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kompensimet për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, pensionet për invalidët e luftës, pensionet të familjes së dëshmorit të UÇK-së dhe familjes së të zhdukurit të UÇK-së, pensionet të familjes së viktimave civile, dhe asistenca sociale.

Testi i të hyrave familjare- është vlerësimi i mirëqenies financiare të familjeve përmes treguesve të burimeve të ndryshme të të ardhurave (p.sh. paga dhe medijtje, transfere sociale, subvencione qeveritare dhe të tjera) kundrejt një pragu të caktuar në kriteret e këtij Programi.

Pasuri e patundshme- janë të gjitha asetet e patundshme në pronësi të ekonomisë familjare, përfshirë tokën, ndërtesat, dhe pronat e tjera të patundshme që kanë vlerë të konsiderueshme dhe mund të përdoren ose të shfrytëzohen nga ekonomia familjare.

Testi i pasurisë së patundshme- do të vlerësojë vlerën kumulative të pasurisë së patundshme të Ekonomisë Familjare duke llogaritur shumën e çdo aseti në pronësi të pjesëtarëve të ekonomisë familjare dhe duke krahasuar atë kundrejt një pragu të caktuar me kriteret e këtij Programi.

Shuma e subvencionit të faturës së energjisë elektrike- është shuma e asistencës financiare të faturës së energjisë elektrike, e llogaritur sipas kriterëve të këtij Programi.

GRUPET E TARGETUARA

Aplikimi do të jetë i hapur për të gjithë qytetarët. Ndërsa Ekonomitë Familjare (EF) që kualifikohen për subvencionim në bazë të Programit janë ato të cilat kanë të hyra mujore në nivel më të ulët ose të barabartë me 150 euro për person/anëtar ose thënë ndryshe, 600 euro për 4 anëtarë (të hyrat kumulative do përpjesëtohen me numrin e anëtarëve në ekonomisë familjare të deklaruar nga aplikuesi, për të vlerësuar nëse janë më pak ose të barabarta me pragun e të hyrave të vendosur).

KRITERET E PËRFITIMIT DHE LLOGARITJA E SUBVENCIONIT

Mbështetja në formë të subvencionimit të faturës së energjisë elektrike sipas Programit ofrohet për të gjitha ekonomitë familjare që konsiderohen si të cenueshme pas shqyrtimit dhe përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të listuara në këtë Program.

Mënyra e aplikimit

Të gjitha aplikimet do të pranohen përmes platformës eKosova. Moduli i aplikimit do të zhvillohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit. Moduli duhet të dizajnohet në atë mënyrë që të jetë lehtë i kuptueshëm dhe të minimizoj gabimet gjatë aplikimit.

Aplikimi do të jetë i hapur për të gjithë EF-të të cilat mendojnë që i plotësojnë kriteret për tu konsideruar si konsumatorë të cenueshëm të energjisë elektrike. Personat që shprehin interesim për aplikim, mirëpo për arsye të ndryshme nuk kanë qasje në modulin e aplikimit nga shtëpitë e tyre, kanë mundësinë që aplikimin ta realizojnë përmes asistimit të Qendrave për Punë Sociale. Aplikimi bëhet nga kryefamiljari i Ekonomisë Familjare dhe bëhet për një njehsor të vetëm elektrik.

Moduli i aplikimit do të jetë i hapur nga tetori deri në fund të muajit mars të vitit vijues. Gjatë kësaj periudhe qytetarët kanë mundësinë të aplikojnë si dhe të modifikojnë aplikimin e tyre. Megjithatë qytetarët të cilët duan të përfitojnë për gjithë periudhën e paraparë në Program, duhet të aplikojnë në muajin e parë të hapjes së aplikimit. Ekonomitë Familjare që aplikojnë prej muajit të dytë dhe tutje, do të shqyrtohen për përfitim vetëm për periudhën e mbetur, pra nuk do të ketë shqyrtim retroaktiv.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve posedon të dhënat e përfituesve nga programet e viteve paraprake, andaj këto të dhëna do të përditësohen dhe do të përdoren për të vlerësuar statusin e këtyre Ekonomive Familjare bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Program. Të dhënat e përfitueseve nga pilot-Programi që kanë qenë duke banuar me qira nuk do të përdoren për shkak se vendbanimi i tyre mund të ketë ndërruar brenda kësaj periudhe dhe si pasojë nuk mund të targetohen.

Kriteret e përgjithshme

Për të përfituar nga ky Program, Ekonomia Familjare duhet të plotësojë në mënyrë kumulative kriteret si në vijim:

- Të gjithë anëtarët e Ekonomisë Familjare të jenë shtetas të Republikës së Kosovës me banim të përhershëm në territorin e Republikës së Kosovës ose shtetas të huaj të pajisur me leje të qëndrimit të përhershme në territorin e Republikës së Kosovës.
- Të hyrat mesatare mujore për periudhën 12-mujore (korrik - qershor) të Ekonomisë Familjare të jenë të barabarta ose më pak se njëqind euro (150 €) për anëtar të Ekonomisë Familjare.

- Vlera kumulative e patundshmërive (testi i asetëve) në pronësi të anëtarëve të Ekonomisë Familjare të jetë e barabartë ose më pak se njëqind mijë euro (100,000 €).
- Vlera e faturës mujore të energjisë elektrike është më e lartë sesa 2% e të hyrave mesatare mujore të EF.

Për të gjitha ekonomitë familjare të cilat paguajnë qira për banim, totalit të të hyrave mesatare mujore i zbritet shuma e qirasë mujore, por jo më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) e totalit të të hyrave mesatare mujore. Aplikuesi duhet të ofrojë dëshmi për qira që mund të jetë kontrata e qirasë apo transaksioni bankar për qira.

Niveli maksimal i subvencionit

Të hyrat mujore sipas këtij Programi konsiderohen të gjitha të ardhurat mujore të ekonomisë familjare me përjashtim të kategorive: pensionet për personat me aftësi të kufizuara, kompensimet për personat e verbër, pensionet për invaliditet në punë, kompensimet për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kompensimet për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, pensionet për invalidët e luftës, pensionet të familjes së dëshmorit të UÇK-së dhe familjes së të zhdukurit të UÇK-së, pensionet të familjes së viktimave civile, dhe asistencë sociale.

Sasia e energjisë e cila mund të subvencionohet për EF ndahet në tri (3) kategori varësisht prej mesatares të të hyrave mujore të EF-së për anëtar:

1. Për EF të cilat kanë të hyra mesatare mujore nga zero euro (0 €) deri pesëdhjetë euro (50 €) për anëtar, u takon subvencioni prej 150 kwh/muaj për anëtar.
2. Për EF të cilat kanë të hyra mesatare mujore nga pesëdhjetë euro (50 €) deri njëqind euro (100 €) për anëtar, u takon subvencioni prej 100 kwh/muaj për anëtar.
3. Për EF të cilat kanë të hyra mesatare mujore nga njëqind euro (100 €) deri njëqind e pesëdhjetë euro (150 €) për anëtar, u takon subvencioni prej 50 kwh/muaj për anëtar.

Niveli maksimal i subvencionit të faturës së energjisë elektrike për një EF është vlera e faturës për muajin përkatës, ose niveli prej 50 euro në muaj, cilado që është më e ulët. Ministri me vendim mund të caktojë kriteret dhe kushtet tjera shtesë për EF përfituese si dhe për përlllogaritjen e subvencionit.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE TE INTERESIT

Zbatimi i suksesshëm i Programit të Mbështetjes për Konsumatorët e Cenueshëm të Energjisë kërkon koordinim efektiv midis institucioneve për të siguruar ekzekutimin e rregullt dhe transparent të subvencioneve. Institucionet e përfshira në këtë proces do të jenë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe Furnizuesi i Shërbimit Univerzal (FSHU). Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) mbikëqyr zhvillimin e politikave, siguron disponueshmërinë e fondeve dhe monitoron zbatimin e programit. Komisioni Zbatues menaxhon verifikimin të aplikimeve, përgatit

listat e përfituesve dhe koordinon pagesat e subvencioneve. Komisioni i Ankesave shqyrton ankesat e ekonomive familjare, ndërsa Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) menaxhon platformën e aplikimit. Institucione të tjera, si Agjencia e Regjistrimit Civil, Administrata Tatimore e Kosovës, Qendrat për Punë Sociale dhe Furnizuesi i Shërbimit Univerzal, mbështesin procesin duke ndarë të dhëna dhe lehtësuar zbatimin e programit.